



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Fjala përshëndetëse në takim me studentët aktuarë

Tiranë, Shqipëri

Znj. Enkeleda Shehi,

Drejtoreshë e Përgjithshme Ekzekutive

21 shkurt 2017

Përshëndetje,

Dëshiroj të falenderoj në radhë të parë të ftuarit, të cilët kanë ardhur për të përshëndetur studentët tanë aktuarë. Faleminderit që keni lënë angazhimet tuaja të tjera për të qenë me ne sot dhe për të ndarë mendimet tuaja.

Siç jeni në dijeni ky është programi i tretë për kualifikim profesional për aktuar që zhvillohet në vend. Fillimisht unë dëshiroj t'ju përgëzoj që keni zgjedhur të studioni për profesionin e bukur dhe të vështirë të aktuarit dhe gjithashtu të angazhoheni në këtë program afatgjatë që AMF organizon në bashkëpunim me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër, si dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve. Është për të përgëzuar fakti që keni arritur deri në këtë pikë të programit duke kaluar me sukses të gjitha provimet pararendëse, duke ju mbetur shumë pak punë deri në ceremoninë e certifikimit.

AMF, si Autoriteti mbikëqyrës i profesionistëve të licencuar si aktuarë, ka mbështetur gjithnjë rrugën e nisur drejt formimit të profesionit të aktuarit në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij. Nëpërmjet mundësive të tilla, ju përfitoni arsimimin bazë aktuarial dhe do të zhvilloheni më tej falë dëshirës dhe punës tuaj profesionale. Ju tashmë jeni duke ndërmarrë "një zotim të përbashkët për të zgjidhur problemet e përbashkëta të tregut tonë". Tregjet që mbikëqyr AMF janë relativisht të vegjël, nisur nga madhësia dhe kontributi që ata kanë në ndërmjetësimin financiar, në raport edhe me PBB, por me një dinamikë intensive zhvillimi. Në këtë kontekst nevojiten njerëz të kualifikuar për t'i menaxhuar dhe zhvilluar ato.

Të jesh aktuar nuk është e thjeshtë. Besoj tani e dini më mirë se kushdo tjetër vështirësinë e të mësuarit edhe duke punuar apo edhe duke pasur familje për t'u kujdesur. Por mbi të gjitha duhet të kuptoni rëndësinë që ky profesion ka në tregjet që mbikëqyren nga AMF por jo vetëm.

Ky program afatgjatë ka kontribuar për të vendosur themelet e dijes së shkencës aktuariale dhe tashmë ju jeni prezantuar me zbatimin praktik të metodave dhe teknikave aktuariale të cilat shërbejnë në industrinë e sigurimeve (sigurimin e Jetës dhe të Jo-Jetës), fondet e investimit, fondet private të pensioneve, etj.

Aktuari i Autorizuar është përgjegjës për llogaritjen e të gjithë tipeve të provigjoneve të sigurimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, llogaritjen e marzhit të aftësisë paguese të shoqërisë, jep kontributin në përgatitjen e drafteve të kushteve dhe termave të policave të sigurimit në shoqëritë e sigurimit, llogaritjen e primeve dhe përfitimeve, hartimin e politikës së risigurimeve të shoqërisë, jep kontributin në hartimin dhe nënshkrimin e planit të biznesit për aplikimin për licencë për një shoqëri të re, apo në planin e rfinansimit për një shoqëri që nuk përmbush kërkesat ligjore të aftësisë paguese, kryerjen e testeve të gjendjes financiare të shoqërisë, etj.

Si përfaqësuese e AMF-së dhe duke qenë një aktuale vetë, unë uroj që ju tashmë të jeni në gjendje të vini në praktikë gjithë njohuritë e marra në këtë trajnim afatgjatë për kualifikim profesional, për të përmbushur pritshmëritë dhe kryer detyrat të cilat i citova më lart me kompetencë, ndershmëri dhe profesionalizëm. Gjithashtu shumë e rëndësishme është edhe rritja juaj profesionale në vazhdimësi që do të arrihet duke punuar fort dhe me përkushtim, duke marrë pjesë në trajnime për edukim në vazhdim të organizuara në vend apo më gjerë, për të përditësuar dijet dhe rritur aftësitë profesionale, si pjesë e procesit të marrjes dhe rritjes së standardit të këtij profesioni dhe në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve që ju do të ofroni.

Përveç aftësive profesionale, të cilat janë të domosdoshme për të ushtruar profesionin e aktuarit, një profesionist i vërtetë duhet të mbështetet në parime, duhet të njohë dhe të zbatojë kodin e sjelljes së profesionit, të ketë njohuri bashkëkohore dhe përvojë në sektorin financiar.

Përpara se t'ia kaloj fjalën të ftuarve, dëshiroj të falenderoj Z. Neil Hilary si përfaqësues i Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve të Londrës, për ndihmesën e madhe të dhënë gjatë një dekade tashmë dhe sidomos për angazhimin dhe bashkëpunimin e tij në këtë program të tretë, bashkëpunim pa të cilin programi nuk do të ishte zhvilluar dot dhe shpresoj shumë që ky bashkëpunim do të jetë po kaq i suksesshëm edhe në të ardhmen. Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon për të gjithë lektorët e angazhuar në mësimdhënie, të cilët me kontributin e tyre bënë të mundur realizimin me sukses të këtij programi.

Në fund dëshiroj t'ju përgëzoj të gjithë ju edhe një herë, për përkushtimin me të cilin keni përballuar vështirësitë e këtij programi afatgjatë shumë profesional dhe tashmë jeni të gatshëm për t'u angazhuar me sfidat dhe vështirësitë e punës së aktuarit.

Shume suksese dhe faleminderit,